
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	Operatorë Ekonomik: <b>Zogu Architecture Group SH.P.K.</b> me adresë në <b>Prishtinë</b> <b>Operatorëve Ekonomik</b> <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	<b>Astrit Mullabazi</b> , Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>19.05.2026</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **18.05.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Zogu Architecture Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Zogu Architecture Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik: **Zogu Architecture Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.04.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **18.05.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

#### **Pretendimi 1: Certifikatat ISO jane te tepruara, te paarsyetuara dhe kufizuese**

Ne Dosjen e Tenderit eshte kerkuar qe Operatori Ekonomik te jete i pajisur me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, PAS 99:2012 dhe ISO/IEC 27001:2013. Keto certifikata jane vendosur ne menyre kumulative si kushte kualifikuese, pa arsyetuar pse secila prej tyre eshte e domosdoshme per kontraten "Hartimi i projekteve te ndryshme".

Kerkesa per ISO 9001 mund te kete nje lidhje te pergjithshme me menaxhimin e cilesise, mirepo kerkesa per ISO 14001, ISO 45001, PAS 99 dhe ISO/IEC 27001 nuk eshte arsyetuar ne menyre konkrete. AK nuk ka dhene asnje shpjegim se pse nje kontrate per hartim projektsh kerkon detyrimisht standard per menaxhim mjedisor, siguri dhe shendet ne pune, sistem te integruar menaxhimi dhe siguri te informacionit.

Veçanerisht problematike jane PAS 99 dhe ISO/IEC 27001. PAS 99 paraqet kerkesa shtese per sistem te integruar te menaxhimit dhe e rendeon panevojshem kriterin. ISO/IEC 27001 lidhet me sigurine e informacionit, ndersa AK nuk ka treguar se kjo kontrate perfshin trajtim te te dhenave te ndjeshme, sisteme informative, databaza sensitive apo ndonje rrezik te veçante te sigurise se informacionit.

Vendosja e ketyre standardeve si kushte minimale, pa arsyetim konkret, nuk eshte veprim profesional. Kjo krijon barre artificiale per operatoret ekonomik dhe e ngushton konkurrencen ne menyre te pajustificueshme. Zyra e Prokurimit nuk mund te vendose lista certifikatash vetem per ta bere tenderin me "te forte" ne dukje; secili kriter duhet te kete lidhje te drejtperdrejte, te matshme dhe te domosdoshme me objektin e kontrates.

Andaj, kerkojme largimin e PAS 99:2012 dhe ISO/IEC 27001:2013 si kriteret minimale, si dhe rishqyrtimin serioz te ISO 14001 dhe ISO 45001, perveç nese AK jep arsyetim konkret, teknik dhe te verifikueshem per domosdoshmerine e tyre.

### Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim lidhur me kriteret e certifikimeve ISO të përcaktuara në Dosjen e Tenderit për aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve të ndryshme", Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsytet në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kriteret e kërkuara në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës. Kërkesat për certifikimet ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, PAS 99:2012 dhe ISO/IEC 27001:2013 janë vendosur me qëllim të garantimit të cilësisë së shërbimeve, menaxhimit efektiv organizativ, sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit, si dhe sigurimit të standardeve profesionale gjatë realizimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha standardet e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë vendosur në mënyrë proporcionale, jo diskriminuese dhe në funksion të sigurimit të realizimit cilësor dhe të sigurt të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ligjore dhe diskrecion profesional që, në përputhje me nevojat e projektit dhe kompleksitetin e shërbimeve, të përcaktojë kriteret minimale të kualifikimit që i konsideron të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Komuna e Rahovecit, me rastin e vendosjes së kriterëve apo kërkesave kualifikuese ka kërkuar vetëm ato kërkesat dhe dëshmitë që janë ngushtë të lidhura me sigurimin e cilësisë dhe kualitetit të lëndës së prokurimit/ shiko Interpretimin Nr. 26 të dt. 09.06.2023.

Ju sqarojmë se Operatorët Ekonomikë që ofertojnë në formë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, nuk obligohen që secili anëtar individualisht të posedojë të gjitha standardet ISO të kërkuara në dosjen e tenderit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur përderisa standardet ISO të kërkuara plotësohen nga lideri i grupit ose nga anëtarët e grupit në mënyrë të përbashkët, ashtu që Grupi në tërësi të përmbushë kriterin e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik lidhur me largimin e certifikatave PAS 99:2012 dhe ISO/IEC 27001:2013, si dhe rishqyrtimin e kërkesave për ISO 14001 dhe ISO 45001, **refuzohet si i pabazuar.**

### **Pretendimi Nr. 2 Ankimor:**

#### **Pretendimi 2: Kërkesat për softuere janë të orientuara drejt produkteve të caktuara**

Ne Dosjen e Tenderit është kërkuar licence valide për softuerin Plateia ose të ngjashme dhe Autodesk AEC Collection ose të ngjashme. Ne sqarimin e dhënë, AK ka deklaruar se këto softuere janë “mjete thelbësore” për realizimin e detyrave të projektimit, analizimit dhe modelimit.

Ky formulim është problematik. Kur Autoriteti Kontraktues i quan softueret e caktuar “mjete thelbësore”, atëherë praktikisht po e orienton konkurrencen drejt produkteve konkrete komerciale. Vetëm përdorimi i shprehjes “ose të ngjashme” nuk e eliminon efektin kufizues, nëse në substancë AK vazhdon t’i trajtojë Plateia dhe Autodesk AEC Collection si standard të domosdoshëm.

Në treg ekzistojnë softuere të tjera profesional për projektim, modelim, analizë dhe përgatitje të dokumentacionit teknik. AK nuk ka treguar pse shërbimet e kontratës nuk mund të kryhen me softuere të tjera ekuivalente. Nuk është detyrë e AK-së të përcaktojë se cili produkt komercial është “thelbësor”, por të përcaktojë funksionet dhe rezultatet që duhet të arrihen.

Në sqarim, AK ka pranuar që dëshmitë për përdorimin e ligjshëm të softuerit mund të jenë edhe abonime, licenca cloud, kontrata përdorimi, konfirmime nga prodhuesi apo distributori, dhe jo vetëm fatura blerjeje. Kjo e konfirmon se kriteri fillestar në Dosje ka qenë i formuluar ngushtë dhe jo mjaftueshëm qartë.

Kërkojmë që AK të mos mjaftohet me sqarime formale, por ta ndryshojë Dosjen e Tenderit dhe kriterin ta formulojë në mënyrë neutrale: “softuere profesional për projektim, modelim, analizë dhe përgatitje të dokumentacionit teknik, ose ekuivalent, me dëshmi valide për qasje të ligjshme”.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:**

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kërkesat për softuerët profesionalë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsyet në vijim:

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar posedimin e licencave valide për softuerët “Plateia ose ekuivalent” dhe “Autodesk AEC Collection ose ekuivalent”, duke specifikuar qartë mundësinë e ofertimit edhe me softuerë ekuivalentë që përmbushin funksionalitetet dhe kërkesat teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa nuk është vendosur me qëllim favorizimi të ndonjë produkti të caktuar komercial, por për shkak se softuerët e kërkuar përfaqësojnë standarde profesionale të përdorura gjerësisht në fushën e projektimit, modelimit, analizës dhe përgatitjes së dokumentacionit teknik.

Autoriteti Kontraktues ka përdorur formulimin “ose të ngjashëm”, çka garanton trajtim të barabartë dhe konkurrencë të hapur për të gjithë operatorët ekonomikë që posedojnë softuerë të tjerë profesionalë me kapacitete dhe funksionalitete të krahasueshme.

Po ashtu, natyra e kontratës dhe kompleksiteti i shërbimeve të kërkuara kërkojnë përdorimin e softuerëve profesionalë të avancuar, të cilët sigurojnë kompatibilitet të dokumentacionit teknik, interoperabilitet të të dhënave, saktësi në modelim dhe analizë, si dhe mundësi për bashkëpunim profesional ndërmjet ekipeve projektuese dhe Autoritetit Kontraktues.

Në këtë kontekst, si dëshmi të pranueshme konsiderohen: faturat e blerjes ose abonimit, konfirmimet zyrtare nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, si dhe dëshmi të pagesës që vërtetojnë vlefshmërinë aktive të licencës.

Kjo kërkesë është vendosur për të parandaluar përdorimin e softuerëve jo të licencuar (ilegal), të cilët mund të ndikojë negativisht në cilësinë e projektit, sigurinë e të dhënave dhe vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit teknik.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është e domosdoshme për sigurimin e realizimit profesional, cilësor dhe teknikisht të saktë të shërbimeve të kërkuara.

Prandaj, kërkesa e operatorit ekonomik për ndryshimin e kriterit lidhur me softuerët profesionalë **refuzohet si e pabazuar.**

### **Pretendimi Nr. 3 Ankimor:**

#### **Pretendimi 3: Pajisjet teknike/gjeodezike janë teper specifike dhe krijojnë dyshim serioz për kritere të pershtatura**

Pjesa me e rëndë dhe me shqetesuese e kesaj Dosjeje eshte kerkesa per pajisjet teknike/gjeodezike. AK ka kerkuar, nder te tjera, dron profesional me kamere jo me pak se 60 MP dhe PPK, GPS GNSS RTK Advanced Engine System me minimum 1408 kanale satelitore, dual kamera, rilevim 3D, laser, modelim 3D dhe real view, Total Station Robotic + GPS + Hybrid, si dhe SLAM LIDAR 3D Scanner System me RTK dhe PPK te integruar, minimum 640k pika/sekond dhe dy kamera minimum 48 MP.

Ne sqarimin e dhene, AK vetem i ka perseritur keto kerkesa dhe ka deklaruar se ato jane “minimum teknik i domosdoshem” per saktësi, reduktim pasigurish, RTK/PPK, modelim 3D dhe dokumentim teknik. Kjo nuk eshte pergjigje profesionale. Ky eshte arsyetim

formal dhe i pergjithshem, pa asnje analize konkrete.

AK nuk ka treguar:

- cilat projekte konkrete brenda kontrates kerkojne SLAM LIDAR 3D Scanner;
- pse duhet domosdoshmerisht dron me kamere 60 MP;
- pse GPS-i duhet te kete saktesisht minimum 1408 kanale;
- pse duhet Total Station Robotic + GPS + Hybrid;
- pse nuk mjaftojne pajisje profesionale ekuivalente me parametra tjere funksionale;
- pse keto kerkesa jane proporcionale me objektin dhe vleren e kontrates.

Kjo menyre e hartimit te kriterëve nuk eshte neutrale. Kriteret nuk jane formuluar mbi bazen e rezultatit qe duhet te arrihet, por mbi bazen e karakteristikave te pajisjeve te caktuara. Kjo krijon dyshim te forte se kriteret jane pershtatur sipas pajisjeve qe i posedon nje numer i kufizuar operatorësh ekonomik.

Fakti qe AK shkruan se pranohen pajisje ekuivalente nuk e eliminon shkeljen. AK ka thene se pajisjet ekuivalente pranohen vetem nese kane "performancat e specifikuara ne dosjen e tenderit". Pra, ne realitet, AK nuk po pranon ekuivalence funksionale, por vetem pajisje qe perserisin te njejtat parametra te ngushte. Kjo eshte ekuivalence formale, jo hapje reale e konkurrencen.

Kjo qasje eshte e papranueshme. Nese Zyra e Prokurimit ka nevojë per rilevim gjeodezik, modelim 3D, incizim topografik dhe perpunim te te dhenave, atehere kriteret duhet te formulohet mbi baze funksionale: saktësia e kerkuar, lloji i matjeve, formati i rezultateve, aftësia per perpunim dhe dorezim te dokumentacionit. Nuk duhet te imponohen parametra si 60 MP, 1408 kanale, dual kamera, RTK/PPK te integruar dhe SLAM LIDAR.

Keto kriterë, ne formen aktuale, jane joproportionale, kufizuese dhe ngritin dyshime serioze mbi profesionalizmin dhe paanshmerine e personave qe i kane hartuar dhe miratuar. Nese kriteret nuk ndryshohen, kjo procedure do te duket si procedure e projektuar per te perjashtuar konkurrencen reale dhe per te favorizuar kapacitete te caktuara ekzistuese ne treg.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:**

Pas shqyrtimit të pretendimit të operatorit ekonomik lidhur me kriteret për pajisjet teknike/gjeodezike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues e refuzon këtë pretendim si të pabazuar për arsyet në vijim: Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesat minimale për pajisjet teknike dhe gjeodezike bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat profesionale të kontratës për hartimin e projekteve, incizimeve gjeodezike, modelimit 3D, analizave teknike dhe përgatitjes së dokumentacionit teknik.

Kërkesat për pajisje si dron profesional, GPS GNSS RTK, Total Station Robotik, SLAM LiDAR 3D Scanner të specializuara janë vendosur për të garantuar saktësi të lartë në matje, efikasitet operacional, kompatibilitet të të dhënave dhe realizim cilësor të detyrave projektuese dhe gjeodezike që parashihen në kuadër të kontratës.

Specifikimet teknike minimale të kërkuara nuk janë përcaktuar për të favorizuar ndonjë operator ekonomik apo ndonjë prodhues të caktuar, por për të siguruar standard minimal profesional dhe teknik të pajisjeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë parametrat minimalë teknikë që i konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektivave të projektit.

Sa i përket pretendimeve konkrete:

- Kërkesa për **SLAM LiDAR 3D Scanner** është vendosur për shkak të nevojës për incizim të avancuar 3D, gjenerim të modeleve precize digjitale dhe përpunim efikas të të dhënave hapësinore në terrene dhe objekte komplekse, ku kërkohet saktësi dhe shpejtësi e lartë e incizimit.
- Kërkesa për **dron profesional me kamerë minimum 60 MP** është përcaktuar për të siguruar rezolucion dhe cilësi të lartë të ortofotove, modeleve 3D dhe dokumentimit teknik vizual, të nevojshëm për projektim dhe analiza profesionale.
- Kërkesa për **GPS GNSS RTK me minimum 1408 kanale satelitore** është vendosur me qëllim të sigurimit të saktësisë së lartë në matje, stabilitetit të sinjalit dhe performancës së pajisjes në kushte të ndryshme të terrenit dhe mbulueshmërisë satelitore.
- Kërkesa për **Total Station Robotik + GPS + Hybrid** lidhet drejtpërdrejt me nevojën për integrim të metodave moderne të matjes dhe realizim efikas të punëve gjeodezike dhe projektuese në terren.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kërkesat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që kërkohen.

Gjithashtu, Dosja e Tenderit nuk ndalon përdorimin e pajisjeve ekuivalente (të ngjashme) profesionale, përderisa ato përmbushin parametrat minimalë teknikë dhe funksionalë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Prandaj, pretendimi se kriteret janë diskriminuese apo të orientuara drejt operatorëve të caktuar është i pabazuar.

Theksohet se këto kërkesa **nuk janë të lidhura me marka apo prodhues të caktuar**, por janë të bazuara në performancë dhe funksionalitet. Operatorët ekonomikë mund të ofrojnë çdo pajisje ekuivalente (me performancat e specifikuar në dosjen e tenderit) ose më të avancuar që përmbush këto kërkesa minimale.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe sigurimit të konkurrencës së drejtë, duke përcaktuar vetëm ato kërkesa teknike që konsiderohen të domosdoshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Prandaj, kërkesa e operatorit ekonomik për ndryshimin apo largimin e kritereve teknike për pajisjet gjeodezike **refuzohet si e pabazuar**.

## **Përfundim**

Pas shqyrtimit të plotë të kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga operatori ekonomik, Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha pretendimet e ngritura janë të pabazuara dhe nuk ofrojnë argumente të mjaftueshme juridike apo profesionale për ndryshimin e kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues konsideron se:

- kriteret lidhur me certifikimet ISO janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe janë vendosur për të garantuar standarde profesionale, menaxhim cilësor, siguri organizative dhe mbrojtje të informacionit;
- kërkesat për softuerët profesionalë janë përcaktuar për të siguruar funksionalitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, duke lejuar shprehimisht edhe përdorimin e zgjidhjeve ekuivalente;
- kriteret për pajisjet teknike/gjeodezike janë vendosur mbi bazën e nevojave reale të projektit dhe synojnë garantimin e saktësisë, efikasitetit dhe cilësisë profesionale në realizimin e shërbimeve të kërkuara.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë në përputhje me objektin e kontratës, janë proporcionale, jo diskriminuese dhe të nevojshme për realizimin profesional dhe cilësor të kontratës.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, duke siguruar trajtim të barabartë, konkurrencë të drejtë dhe transparencë në përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik **refuzohet në tërësi si e pabazuar**, ndërsa kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit mbesin të pandryshuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju mundë të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>